

**Qëndrimi i Komisionerit për çështje të kuptimit dhe zbatimit të ligjit material, në rastin e lëvizjes së nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, brenda të njëjtës kategori, në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore**

*“...Duke analizuar veprimin administrativ të kryer në këtë rast, konstatojmë se kemi të bëjmë me një lëvizje brenda klasës së nivelit të lartë drejtues, e cila për institucionet e pavarura dhe administratën vendore nuk është e rregulluar në mënyrë të posaçme, ashtu si është e rregulluar për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues në administratën shtetërore, nëpërmjet vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND- së”, i ndryshuar.*

*Për tipologjinë e institucioneve të pavarura, ku përfshihet edhe administrata vendore është rregulluar me hollësi vetëm momenti i pranimit të nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese (neni 32 i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar) dhe jo menaxhimi i mëtejshëm i kësaj kategorie të nëpunësisë civile, brenda institucionit ku ata punojnë.*

*Për këtë arsye, meqenëse ndodhemi në një moment të tillë të menaxhimit të marrëdhënies në shërbimin civil për nivelin e lartë drejtues në institucionet e pavarura, vlerësojmë se ky rast duhet të analizohet me hollësi me qëllim që të unifikohet procedura gjatë zbatimit në praktikë të këtij instituti të ligjit.*

*Komisioneri vlerëson se, një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, në institucionet e pavarura, mund të caktohet në një pozicion të rregullt në nivele të larta drejtuese, brenda institucionit ku ai punon, pozicione të cilat parashikohen në pikën 4, të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil, ose pozicione të barasvlershme me to, nëse ai ka fituar statusin në kategorinë e nëpunësit civil të lartë drejtues, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil.*

*Në kushtet kur, për këtë kategori të nëpunësisë civile nuk parashikohet si mundësi mobiliteti, instituti i lëvizjes paralele brenda kategorisë dhe nuk njihet e drejta e nëpunësit civil për të përzgjedhur pozicionin e punës, atëherë lëvizja e tyre, kur shfaqet një pozicion i ri në këtë kategori, për analogji edhe me rregullimet e TND-së, mund të bëhet nga klasa ekzistuese e nëpunësve të lartë drejtues, (sipas parimeve të vendosura në fazën e emërimit të këtyre nëpunësve në një pozicion të rregullt të shërbimit civil), nga njësia përgjegjëse me propozim të eprorit direkt, që në rastin konkret është titullari i institucionit.”*